

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Përshëndetje, të gjithëve!

Mirëmbërëma, të nderuar qytetarë, që po ndiqni këtë seancë maratonë! Jemi duke folur për portin e Durrësit, për projektin e ri, i cili do të transformojë portin aktual dhe do ta spostojë atë në një lokacion të ri, që është projekti i radhës për të gllabëruar pasuritë publike të këtij vendi, për t'i tjetërsuar ato dhe për t'i përdorur për përfitime të caktuara, pa dyshim jo për përfitimin e vendit, në nivelin që do të duhej të ishte, për sa u takon investimit dhe vlerës së madhe të tij. Dukshëm mund të përkthehet si akti i shitjes së zemrës së Shqipërisë, të një pike strategjike siç është Durrësi. Është një investim mbi 2 miliardë euro, më i madhi deri më sot, i cili do të rrëmbejë një sipërfaqe të konsiderueshme, rreth 818 mijë metër katror.

Sot do të duhet të kishte transparencë, konsultim të gjerë publik dhe konkurrencë të hapur për një projekt të tillë madhor, por qeveria shqiptare bën të kundërtën. Në mungesë të plotë të transparencës kërkoi që të kalojë me procedurë të përshpejtuar, në terr të plotë, një projekt që jo vetëm do të ketë kosto për sa i përket ridimensionimit të aktivitetit portual në vend, por edhe impaktit në jetën e qindra, mijëra banorëve dhe bizneseve në qytetin e Durrësit. Qeveria po shet rreth 818 mijë metra katrorë truall, duke e kaluar atë në pronësi të investitorit privat Eagle Hills me koston vetëm 1 euro për metër katror pas përfundimit të projektit.

Investitori strategjik preferencial, më strategjik se gjithë strategjikët e tjerë, do të përjashtohet, gjithashtu, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në nivelin 3% të vlerës së investimit ose afro 60 milionë euro, që i falet këtij investitori strategjik preferencial. Do të përjashtohet, gjithashtu, nga detyrimi prej 3% i fondit të strehimit social ose mbi 40 mijë metra katrorë ndërtim, me vlerë 60 milionë euro edhe kjo. Gjithashtu edhe lehtësirat e tjera, siç është trualli, që do të kalohet në pronësi të investitorit në vlerën vetëm 1euro për metër katror. Duke mbledhur të gjitha lehtësitë që shteti shqiptar i vendos në dispozicion këtij investitori strategjik, rezulton se kontributi i shtetit shqiptar do të jetë në vlerën 349 milionë euro deri në 628 milionë euro, në varësi nëse do të llogariten çmimet e truallit dhe të ndërtimit me çmimin referencë apo me çmimin e tregut.

Pra, shteti shqiptar dukshëm është duke kontribuar në një vlerë më të madhe në raport me atë çfarë pritet të përfitojë sipas projektit, pas 20 vjetësh, pasi të ketë përfunduar projekti. Kjo është së paku rreth vlerës 280 milionë euro. Sot investon 300 milionë euro deri në 600 milionë euro në këtë projekt dhe pritet që mbas 20 vjetësh të përfitojë 280 milionë euro, dukshëm ajo se çfarë shteti shqiptar i jep sot një investitori të preferuar strategjik, por që është më strategjik se të tjerët, është shumë më tepër sesa ajo që pritet të marrë pas 20 vjetësh. Ku është këtu përfitimi i shtetit shqiptar?! Pse ky është projekti më i mirë dhe në interes të shqiptarëve?!

Kompania fituese e projektit pa garë, pa konkurrencë, pa transparencë, do të investojë fillimisht një kapital vetëm 160 milionë euro për 7 vjetët e parë, nga të cilat vetëm 80 milionë euro janë kapitali i investitorit dhe 80 milionë euro do t'i marrë nga institucionet financiare, pra, kredi bankare. Burimi i financimit për të vazhduar projektin do të jenë paratë e akumuluar nga shitja e apartamenteve, si edhe burime të tjera financimi nga kompanitë që do të jenë garante të vazhdimit të projektit, disa prej tyre të regjistruara edhe në parajsë fiskale. Është një projekt, i cili lë vend, lë hapësira për të pasur pikëpyetje të mëdha për burimin e parave që do të çojnë përpara projektin dhe ndërtimin e një vepre kaq të rëndësishme, strategjike për vendin.

Nga ana tjetër, sot që flasim dhe jemi duke diskutuar për një projekt kaq të rëndësishëm, kanë filluar të shiten apartamentet në projektin që ende nuk ka kaluar në parlamentin e Republikës së Shqipërisë dhe që ende nuk është miratuar në Kuvend. Kjo tregon hapur dhe paturpësisht se sot diskutimi ka një vlerë formale dhe fatkeqësisht ky Kuvend është kthyer në noter të vullnetit të qeverisë dhe larg funksionit kontrollues, eficient siç, në fakt, do të duhej të ishte. Siç e përmenda më sipër, projekti lë hapësira të shumta për burime të dyshimta financimi, duke pasur një probabilitet të lartë për t'u shndërruar në një projekt të pastrimit të parave të pista, që do të ketë, gjithashtu, kosto ekstra financiare dhe sociale për banorët e Durrësit dhe për shtetin shqiptar, sepse do të duhet të kemi një zhvendosje të portit aktual të pasagjerëve dhe të mallrave në Porto Romano, vlerë, e cila mund të jetë diku te 5 miliardë euro që do të duhen të paguhen nga shteti shqiptar ose nga kompania koncensionare, por që në të gjitha rastet do të rëndojnë në taksat portuale.

Pra, do të kemi një kosto ekstra të pallogaritur në këtë projekt. Nga ana tjetër, do të ketë kosto sociale, sepse do të zhbëjë portin historik, mijëra vjeçar të Durrësit, do të zhbëjë një pjesë të historisë, do të falimentojë shumë biznese dhe pashmangshmërisht do të ndikojë në jetën e shumë qytetarëve. Në mbyllje, do ta përkufizoja si një projekt hermetik, që, ndër të tjera, ka cenuar Kushtetutën, nenet 11 dhe 18 të saj për garën dhe konkurrencën e lirë, ka cenuar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, përkatësisht

nenet 71, 74, ku sanksionohet se çdo ndihmë apo privilegj shtetëror, që rrezikon konkurrencën e ndershme, nuk shkon në përputhje me këtë marrëveshje.

Pra, një investitor strategjik preferencial merr lehtësira ekstra investitorit strategjik të zakonshëm, me kompani të parajsave fiskale, që e bëjnë të dyshimtë. Në fakt, cilët janë ata që do të jenë përfituesit final të këtij projekti, që shkatërron historinë dhe ndërton një mjedis të ri betoni në zemrën e Shqipërisë? Jam kundër këtij projekti, i cili për rëndësinë e tij strategjike dhe vlerën e investimit do të duhet të mos ishte projekt i territorit, por projekt i transparencës. Faleminderit!